



Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren
University "Ukshin Hoti" Prizren

Universiteti i Prizrenit University of Prizren Univerziteti Prizren "UKSHIN HOTI"	
Pranuar më dt. 22.05.2023	
Zyra e pranimit	Nr. i protokollit
808	01-297

KËSHILLI DREJTUES

Rruga e Shkronjave Nr. 1, 20000 Prizren -Kosovë; Tel:+381 (0) 29- 232 140; Homepage: www.uni-prizren.com

Kryesues i Këshillit Drejtues
Prof. Asoc. Dr. Arif Murrja

Prizren, më 22.05.2023

Në mbështetje të nenit 19, paragrafi 1 të Ligjit Nr.04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, të nenit 26 të Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren, sipas referencës nr. 04-V-621 të datës 30 maj 2013, duke u bazuar në konkursin publik me Nr. Prot. 01-230, të datës: 20.04.2023, Këshilli Drejtues i Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren, në mbledhjen e mbajtur më 22.05.2023, mori këtë:

V E N D I M

1. Prof. Asoc. Dr. Mentor Alishani, zgjedhet rektor i Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren.
2. Zgjedhja e rektorit bëhet për një periudhë prej katër (4) vitesh.
3. Pranimi i detyrës së rektorit të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren, do të bëhet më 23.05.2023.
4. Të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e rektorit të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren, janë të përcaktuara me Ligjin për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, Statutin e Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren, si dhe aktet tjera nënligjore në fuqi.
5. Të ardhurat personale janë të përcaktuara me Ligjin Nr. 08/L-196 Për Pagat në Sektorin Publik.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

A r s y e t i m

Duke u bazuar në nenin 26 dhe 27 të Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren, Këshilli Drejtues, në mbledhjen e mbajtur më 19.04.2023, mori vendim mbi shpalljen e konkursit publik për pozitën e rektorit të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren. Konkursi publik për pozitën e rektorit të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren, është shpallur më datë 20.04.2023 dhe i njëjti është publikuar në ueb faqen e Universitetit. Senati i Universitetit, në mbështetje të nenit 27 paragrafi 4, të Statutit të Universitetit e ka formuar Komisionin Profesional për shqyrtimin e dokumentacionit dhe propozimin e listës së kandidatëve për rektor. Bazuar në raportin me Nr. Prot. 01-284 të dt.16.05.2023, të Komisionit Profesional për shqyrtimin e dokumentacionit dhe propozimin e listës së kandidatëve për rektor të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren, Këshilli Drejtues, i ka ftuar në intervistë kandidatët të cilët i kanë plotësuar kriteret për pozitën e Rektorit. Pas intervistimit të

kandidatëve, Këshilli Drejtues i Universitetit “Ukshin Hoti” Prizren, në mbledhjen e mbajtur më datë: 22.05.2023, me votim të fshehtë, me 7 Vota PËR, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi pala mund të ushtrojë ankesë në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit në afat prej 15 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t’u dërgohet:

- Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Informacionit;
- Këshillit Drejtues;
- Menaxhmentit;
- Sekretarit të përgjithshëm
- Zyrës ligjore;
- Të përmendurit;
- Arkivi.

Prof. Asoc. Dr. Arif Murrija

Kryesues i Këshillit Drejtues

